



V E N D I M

Nr.523, datë 1.7.2020

P Ë R

MIRATIMIN E CMIMEVE DHE TË KATEGORIVE QË PËRFITOJNË FALAS TEKSTET E BOTUARA NGA QENDRA E BOTIMEVE PËR DIASPORËN, PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 5, të nenit 10, të ligjit nr.16/2018, “Për diasporën”, të pikës 19, të vendimit nr.469, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve për Diasporën”, të ligjit nr.9616, datë 27.9.2006, “Për librin në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Me qëllim mbështetjen e mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë, Qendra e Botimeve për Diasporën boton, siguron dhe shpërndan për kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore dhe ato plotësuese për vitin shkollor 2020-2021, sipas listës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kategoritë që përfitojnë falas tekstet shkollore dhe ato plotësuese të botuara, të siguruara, nga Qendra e Botimeve për Diasporën, janë nxënësit dhe mësuesit, sipas përcaktimeve të vendimit nr.443, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin e procesit mësimor dhe përzgjedhjen e arsimtarëve në diasporë”.
3. Tekstet shkollore të botuara, të siguruara, nga Qendra e Botimeve për Diasporën, duhet të jenë të pajisura nga ana e shtëpisë botuese me logon dhe pullën me hologram përkatëse.



4. Çmimet e teksteve shkollore dhe ato plotësuese për mësimdhënien në diasporën shqiptare vendosen në kopertinën e tyre në përputhje me listën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
5. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga buxheti i miratuar për Qendrën e Botimeve për Diasporën.
6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Diasporën dhe Qendra e Botimeve për Diasporën për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

**MINISTRI I SHITETIT
PËR DIASPORËN**

PANDELI MAJKO

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË**

ANILA DENAJ



Lista 1

**LISTA E TEKSTEVE SHKOLLORE PËR DIASPORËN
PËR VITIN SHKOLLOR 2020 – 2021**

Titulli i librit	Sasia	Çmimi për copë / lekë pa TVSH
Abetare	2532 copë	515
Fletore pune Abetareje	2133 copë	249
Gjuhë shqipe 2	1010 copë	472
Gjuhë shqipe 3	570 copë	411
Gjuhë shqipe 4	507 copë	479
Gjuhë shqipe 5	213 copë	553
Gjuhë shqipe 6	244 copë	562
Gjuhë shqipe 7	137 copë	431
Gjuhë shqipe 8	125 copë	401
Gjuhë shqipe 9	130 copë	513
Gjuhë shqipe 10	74 copë	521
Gjuhë shqipe 11	44 copë	549
Gjuhë shqipe 12	35 copë	660



Letërsia 10	21 copë	542
Letërsia 11	19 copë	567
Letërsia 12	12 copë	678
Matematikë 1	20 copë	626
Histori 4	45 copë	145
Histori 5	20 copë	331
Histori 6	20 copë	227
Histori 7	20 copë	313
Histori 8	11 copë	293
Histori 9	92 copë	310
Dituri natyre 1	50 copë	325
Fletore pune Dituri natyre 1	30 copë	298
Edukim për shoqërinë 1	65 copë	239
Edukim për shoqërinë 2	69 copë	171
Qytetari 3	55 copë	233



Qytetari 4	45 copë	248
Qytetari 5	15 copë	324
Qytetari 6	45 copë	212
Qytetari 7	30 copë	218
Qytetari 8	30 copë	279
Qytetari 9	20 copë	142
Dituri natyre 2	40 copë	310
Fletore pune Dituri natyre 2	30 copë	170
Dituri natyre 3	40 copë	321
Fletore pune Dituri natyre 3	30 copë	269
Fletore pune Dituri natyre 4	30 copë	268
Fletore pune Dituri natyre 5	30 copë	289
Gjeografia 6	4 copë	325



Gjeografia 8	2 copë	291
Gjeografia 9	2 copë	296
Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 1 / Sete shkollore për fillestarë	447 copë	346
Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 2 / Sete shkollore për më të rritur	549 copë	346
Të mësojmë gjuhën amtare dhe kulturën shqiptare 3/ Sete shkollore për më të rritur	191 copë	346
Muzikë 6	5 copë	175
Muzikë 7	5 copë	156
Muzikë 8	5 copë	220
Muzikë 9	5 copë	253
Art pamor 6	5 copë	186
TOTALI	9908 copë	3 985 923 lekë pa TVSH

*TVSH-ja për librin sipas ligjit nr. 96/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar është 6% (gjashtë).